



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 129 dt.28.04.1994

MBI
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN MARS 1994

Në zbatim të Ligjit Nr.7710, dt.10.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror” V.K.M. Nr.622, dt.31.12.1993 “Për dhënie e ndihmës ekonomike” Udhëzimit Nr.9, dt.23.02.1994 të Ministrisë së Punës, Këshilli Bashkiak i mbledhur më dt.28.04.1994, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Mbrojtjes Shoqërore

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike :

1.Për muajin Mars gjithsej 10.509 familje me një fond prej 28.2 milion lekë nga të cilat
- Me ndihmë të plotë 9.257 familje, 27 milion lekë
- Me ndihmë të pjesshme 1.252 familje, 1.2 milion lekë

2.Për diferencat e muajit Janar
- Gjithsej 7.764 familje me një fond prej 9.2 milion lekë
Të detajuara sipas pasqyrës së bashkëngjitur që është pjesë e këtij projekt vendimi.

2. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin Mars 57 familje që nga verifikimi u konstatua se kishin makina, dyqan mirëmbajtje etj, sipas pasqyrës bashkangjitur që është pjesë e këtij vendimi.
3. Të gjobiten sipas shumës së përfituar padrejtësisht
 - 1.Kujtim Kërçuku, 2 antarë (Furrë elektrike), me 3 fishin e shumës
 - 2.Edmond Rira, 4 antarë, falsifikim i çertifikatës, me 2 fishin e shumës
 - 3.Agim Dielli, 3 antarë, tregti me liçensë, 2 fishin e shumës
 - 4.Nazif Elezi, 6 antarë, tregti me liçensë, 2 fishin e shumës
 - 5.Luljeta Mërkuri, 4 antarë, trgti me liçensë, 2 fishin e shumës
 - 6.Avni Joca, 2 antarë, tregti me liçensë, 2 fishin e shumës
 - 7.Bujar Kamza, 3 antarë, tregti me liçensë, 2 fishin e shumës
4. Të ngarkojë administratorët e lagjeve të marrin masa konkrete për të mbrojtur administratorët shoqërorë të njësive të tyre.
5. Pagatorët e Njësive Nr.1 dhe Nr.4 të njoftojnë sipas adresave familjet për kthimin e lekëve (të shkurtit) dhe të ndjekin zyrtarisht arkëtimin e tyre. Njëkohësisht u tërhiqet vëmendja për pakujdesi në punë.
6. Tu jepet vërejtja për pakujdesi në punë administratorëve të Njësisë Nr.2 dhe Nr.9, Rajmonda Dashi dhe Mikela Nuke.
Ndërsa administratori në Njësinë Nr.5, Seit Alushi propozohet për largim nga puna pasi rastin e ka të përsëritur dhe me parregullsi.
7. Ankesat me shkrim të personave ndaj Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.119, dt.29.03.1994 i kalojnë për

kompetencë Inspektoriatit Rajonal të Nd.Ek.të
Prefekturës së Tiranës.

8. Për rastet e veçanta

Të miratojë 115 familje të harruara për muajin Shkurt nga administratorët (Njësia.2 – 15, Njësia.9 – 60).

- Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Mars 1994 këtyre familjeve.
- Kujtim Rapia, 1 anëtar, Nd e plotë, Nj.A.2
- Ridvan Hoti, 1 anëtar, Nd. e plotë, Nj.A.2
- Laurate Myftari, 2 anëtar, Nd. e plotë, Nj.A.5
- Shkëlqim Toska, 4 anëtar, Nd.e plotë, Nj.A.6
- Suejman Preza, 5 anëtar, Nd.e pjesshme maksimale Nj.A.8
- Vasfi Meka, 9 anëtar, Nd. e pjesshme maksimale Nj.A.9
- Arife Peshaj, 1 anëtar, Nd. e plotë, Nj.A.11

9. Për zbatimin e ndjekjen e këtij vendimi ngarkohen Seksioni i Mbrojtjes Shoqërore dhe administratorët e lagjeve.

Seksioni i Financës, pagatorët, arshivistët e njësive administrative, administratorët e lagjeve.
Drejtoria e Personelit në Bashki.

KRYETARI

BESNIK PETRELA